

Emertimi dhe Forma Ligjore

MIKA KORÇA Sh.a Juridik

Nr. P.T.

J 64103104 K

Adresa e Selise

(Ish Ndermarja e Grumbullim Duhanit) - Unaza e qytetit Korce

Data e Krijimit

07/06/1994

Nr. i Rregj. Tregetar

1614620

Veprimtaria kryesore

Grumbullim Perpunim - Eksport Duhane

Korce

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te standarteve Kombetare te kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit 9228 date 29.04.2004 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ")

VITI

2011

Pasqyrat jane individuale

Pasqyrat jane te konsoliduara

Pasqyrat financiare jane te shprehura ne

ALL

Pasqyrat financiare jane te rumbullukasura ne

ALL

Periudha kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga

01.01.2011

Deri

31.12.2011

Data e mbylljes te Pasqyrave Financiare

28.02.2012

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Aleko Mitezi



Nr	AKTIVET	Shenime	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
I	AKTIVET AFATSHKURTERA		1.029.273.102	1.052.984.296
	1. - Aktivet monetare	①	736.182	143.820.575
	> Banka		655.222	143.774.292
	> Arka		80.960	46.283
	2 - Derivatet e Aktivet te mbajtura per tregetim			
	3 - Aktivet te tjera financiare afatshkurtera	②	942.597.680	593.896.579
	> Kliente per mallra , produkte e sherbime		783.623.615	435.779.508
	> Debitore , Kreditore te tjere		40.490.924	42.753.378
	> Tatim mbi fitimin		18.480.555	22.205.745
	> T v sh		100.002.586	93.157.948
	> Te drejta e detyrime ndaj ortakeve			
	4 - Inventari	③	55.122.121	230.167.232
	> Lendet e para		52.291.501	228.620.147
	> Inventar i imet		1.443.951	1.547.085
	> Prodhimi ne proces			
	> Produkte te gatshme		1.386.669	
	> Mallra per rrishtje			
	> Parapagesa per furnizime			
	5 - Aktivet billogjike			
	6 - Aktivet afatshkurtera te mbajtura per rrishtje			
	7 - Parapagime dhe shpenzime te shtyra	④	30.817.119	85.099.910
	> Shpenzime te periudhave te ardheshme		30.817.119	85.099.910
II	AKTIVET AFATGJATA		107.693.696	106.615.153
	1 - Financimet financiare afatgjata			
	2 - Aktivet Afatgjata materiale	⑤	106.669.496	106.615.153
	> Toka		7.231.700	7.231.700
	> Ndertesa		49.426.584	45.976.881
	> Makineri e paisje		46.757.255	49.531.599
	> Aktivet tjera afat gjata materiale		3.253.957	3.874.973
	3 - Aktivet Biologjike afatgjata			
	4 - Aktivet afatgjata jo materiale			
	5 - Kapitali aksioner I pa paguar			
	6 - Aktivet e tjera afat gjata .	⑥	1.024.200	
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		1.136.966.798	1.159.599.449

Nr	PASIVET E KAPITALET	Shenime	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
I	Derivatet		941.742.162	986.683.875
	1. - Aktivët monetare			23.761
	2 - Huamarjet			
	> Overdraftet financiare			
	> Huamarjet afatshkurtera			
	3 - Huatë e parapagimet	⑦	941.667.767	921.466.338
	> Te pagushme ndaj furnitoreve		833.173.752	827.009.002
	> Te pagushme ndaj punonjesve		3.705.650	1.790.355
	> Detyrime per Sigurimet shoqerore		876.085	531.731
	> Detyrime Tatimore per TAP - in		252.854	124.908
	> Detyrime Tatimore per Tatimin mbi fitimin			2.335.663
	> Detyrime tatimore per T V SH			
	> Detyrime tatimore per tatimin ne burim		470.285	865.752
	> Te drejta e detyrime ndaj ortakeve			
	> Dividente per tu paguar			
	> Debitore e kreditore te tjere		103.189.141	88.808.927
	4 - Grantet dhe te ardhura te shtyra	⑧	74.395	65.193.776
	5 - Privizionet Afatshkurtera			
	6 - Te Ardhura te marra ose rregjistrime avance (dif.konv.pasive)			
II	PASIVET AFATGJATA			
	1 - Huatë afatgjata			
	> Hua , bono , dhe detyrime qeraje financiare			
	> Bono te kovertushme			
	2 - Huamarjet te tjera afatgjata			
	3 - Grantet dhe te ardhura te shtyra			
	4 - Provigjonet Afatgjata			
	TOTALI I PASIVEVE (I + II)		941.742.162	986.683.875
III	KAPITALI	⑨	195.224.636	172.915.574
	1 - Aksione te pakices			
	2 - Kapitali I aksionereve te Shoq meme(P F te kons)			
	3- Kapitali aksioner		309.316.568	309.316.568
	4 - Primi I Aksionit		145.835.057	145.835.057
	5 - Njesite ose Aksione te thesarit (Negative)			
	6 - rezervat Statuore			
	7 - Rezervat Ligjore		164.656	164.656
	8 - rezerva te tjera			
	9 - Fitime te pashperndara		-282.400.707	-297.152.448
	10 - Fitime (Humbja) e vitit financiar		22.309.062	14.751.741
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT(I + II + III)		1.136.966.798	1.159.599.449

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

Nr	Pershkrimi I elementeve	Shenime	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
1	Shitje NETO	⑩	471.507.868	389.279.612
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit		22.312.886	1.204.598
3	Ndryshimi ne inventarin prod I gatshem e prodh proces		1.386.669	
4	Materiale te konsumuara		303.418.263	262.517.002
5	Kostot e punes		46.711.834	49.347.886
	Pagat e personelit		39.995.324	42.165.088
	Shpenzime per Sigurimet shoqerore e shendetesore		6.716.510	7.182.798
6	Amortizimet e cvleresimet		14.964.655	9.598.954
7	Shpenzime te tjera		153.904.616	69.792.503
8	TOTALI I SHPENZIMEVE	⑪	518.999.368	391.256.345
9	Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore		-23.791.945	-772.135
10	Te ardhura e shpenz financ nga njesite e kontrolluara			
11	Te ardhura e shpenzimet financiare nga pjesmarjet			
12	Te ardhura e shpenzimet financiare		49.957.504	17.859.539
	12.1 Te ardhura e shpenz financ nga invest te tjera e financ afat gjata		139.977	
	12.2 Te ardhura e shpenzimet nga interesat		60.534	105.929
	12.3 Fitime (humbje) nga kurset e e kembimit		45.949.936	15.898.381
	12.4 Te ardhura e shpenzime te tjera financiare		3.807.057	1.855.229
13	Totali I te ardhurave e shpenzimeve financiare		49.957.504	17.859.539
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9 + / - 13)	⑫	26.165.559	17.087.404
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		3.856.497	2.335.663
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14 - 15)	⑬	22.309.062	14.751.741
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara			

Nr	Pasqyra e Fluksit monetar - Metoda Direkte	Periudha raportuse	Periudha Paraardhese
A	Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
	Mjetet monetare (M M) te arketuara nga klientet	108.505.207	219.157.335
	M M te paguara ndaj furnitoreve e punonjesve	257.017.966	109.604.707
	M M te ardhura nga veprimtarite e tjera	7.919.097	4.974.767
	Interes I paguar		
	Tatim fitimi I paguar	2.466.970	743.762
	M M Neto nga veprimtarite e shfrytezimit	-143.060.632	113.783.633
B	Fluksi monetar nga veprimtarite investuse		
	Blerja e njesise te kontrolluar X minus parate e Arketuara		
	Blerja e Aktiveve afat gjata materiale		
	Te ardhura nga shitja e paisjeve		
	Interes I arketuar		
	Divident I arketuar		
	M M Neto te perdorura ne veprimtarite investuse		
C	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
	Te ardhura nga emetimi I kapitalit aksioner		
	Te ardhura nga huamarjet afatgjata		
	pagesat e detyrimeve te qerese financiare		
	Dividente te paguar		
	M M Neto e perdorur ne veprimtarite financiare		
	Rritja / Renia Neto e mjeteve monetare	-143.060.632	113.783.633
	Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel	143.796.814	30.013.181
	Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel	736.182	143.796.814

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

2011

Nje pasqyre e Konsoliduar

Nr	Emertimi	Kapitali Aksioner qe l perket Aksionereve te Shoqerise Meme						Zoterimet e Aksionereve te pakices	TOTALI
		Kapitali Aksioner	Primi l Aksionit	Aksionet e Thesarit	Rezervat Stat e Ligj	Rez e konvert monedh te hua	Fitimi l pa shperndare		
I	pozicioni ne 31 Dhjetor 2010	309.316.568	145.835.057		164.656		-297.152.448	158.163.833	158.163.833
A	Efektet l ndryshimit te politikave kontabel								
B	Pozicioni l rregulluar								
1	Efektet l ndryshimeve te kurseve te kembimit gjate konsolidimit								
	Totali l te ardhurave dhe shpenzimeve								
2	qe nuk jane njohur ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve								(6.269.222)
3	Fitimi Neto l vitit Financiar						14.751.741	14.751.741	14.751.741
4	Dividentet e paguar								
5	Trasferime ne rezerven e detyrueshme Statuore								
6	Emetimi l Kapitalit Aksioner								
II	Pozicioni me 31 Dhjetor 2011	309.316.568	145.835.057		164.656		-282.400.707	172.915.574	172.915.574
1	Efektet e ndryshimit te kurseve te kembimit gjate konsolidimit								
	Totali l te Ardhurave dhe Shpenzimeve								
2	qe nuk jane njohur ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve								(12.399.416)
3	Fitimi Neto per periudhen kontabel						22.309.062	22.309.062	22.309.062
4	Dividentet e paguar								
5	Emetimi l Kapitalit Aksioner								
6	Aksione te Thesarit te riblera								
III	Pozicioni me 31 Dhjetor 2011	309.316.568	145.835.057		164.656		-260.091.645	195.224.636	195.224.636

RAPORT EKONOMIKO – FINANCIAR
Per vitin ushtrimor dt.01/01/2011 deri 31/12/2011

Per Keshillin Mbikqyres
Per Asamblene e Aksionereve
(Ketu)

Subjekti “Mika Korca” Sh.A si person juridik shqiptar, i regjistruar ne regjistrin e shoqerive tregtare me daten 07/06/1994 me Vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane me Nr.4781 i krijuar me dy ortake, pala shqiptare dhe ajo greke qe zoterojne aksionet e tyre me nje kapital fillestar , perkatesisht 37.98 % nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes dhe 62.02 % Leaf Tobacco A.Michailides S.A .

Ne vitet 1998, 1999 ortaku grek , ka kryer investime duke rinovuar dhe modernizuar teknologjine e prodhimit me metoda bashkekohore, investim ky qe kap shifren 145.835.057 Lek i cili nuk eshte perfshire ne kapitalin e nenshkruar.

Gjate vitit 2011 eshte grumbulluar nje sasi prej 1064 Ton duhan ose 33 % me pak se ne vitin 2007, ndersa ne krahasim me vitin 2010 me teper 4,5 % .

Realizimi i Grumbullimit te Duhanit sipas viteve

Nr.	Periudha	Lloji I duhanit	Sasia neto Kg	Nivelet e grumb. ne % ne vitet			
				2007	2008	2009	2010
1	Viti 2007	Kat-Sam-Llov	1.584.021	-	-	-	-
2	Viti 2008	“ “ “	928.562	- 42%	-	-	-
3	Viti 2009	“ “ “	619.706	- 61%	- 34%	-	-
4	Viti 2010	“ “ “	1.017.860	- 36%	+ 9%	+ 64%	-
5	Viti 2011	“ “ “	1.064.399	-33%	+14%	+ 71%	+4.5%

Duhanet grumbullohen kryesisht ne zonat Elbasan, Fier, Lushnje, Berat, Pogradec, Korce etj si zona me te pershtatshme per prodhim duhani te llojit Katerin, Samsun, Llovine, ku grumbullimin me te madh e kap zona Elbasan me 83,3%, zona Berat 10,4% dhe zona Korçe-Pogradec 5,4% dhe zona Shkoder 0,9 %.

Gjate periudhave te grumbullimit 2007– 2011 njihet nje rritje sistematike ne drejtim te cmimit te blerjes per njesi, e kategorizuar sipas llojeve te duhaneve, si pasqyra e meposhtme:

Pasqyra permbledhese e realizimit te cmimit te grumbullimit sipas viteve si subjekt

Nr.	Periudha	Lloji I Duhanit	Cm.mesatar	Sasia neto Kg	Vlefte Lek
1	Viti 2007	Sam - Llov	186,84	1.548.021,00	289.228.808,50
2	Viti 2008	Sam-Llov-Kat	213,50	928.562,00	198.248.110,00
3	Viti 2009	Kat-Sam-Llov	241,31	619.706,00	149.496.586,00
4	Viti 2010	Kat-Sam-Llov	242,80	1.017.860,00	246.736.656,00
5	Viti 2011	Kat-Sam-Llov	244,12	1.064.399,00	259.837.426,00

Pasqyra e realizimit te cmimit sipas zonave, llojit te duhanit
per vitin 2010-2011

Nr.	Zona	Lloji i Duhanit	Cmimi Mesatar Lek/Kg	Sasia neto	Vlefte ne lek
1	Korça	Katerin	252,32	57.790,00	14.581.651,60
2	Berati	“ “	210,58	110.765,15	23.324.659,35
3	Elbasani	“ “	248,27	887.019,80	220.221.084,85
4	Shkoder	Llovin	193,79	8.824,00	1.710.030,00
Shuma			244,12	1.064.398,95	259.837.425,80

Gjate procesit te perpunimit ne fabrike duhet te theksojme se gjate ketij viti iu kushtua nje vemendje dhe pune intensive ne drejtim te klasifikimit paraprak ne lloje e cilesi e cila solli si rrjedhoje nxjerrjen e nje produkti te gatshem mjaft cilesor, qe u pasqyrua edhe ne cmimin mesatar te shitjes ne Euro prej 3,28 € nga 2,90 € ne vitin 2010 dhe ne vlefte Leku ne 463 Lek/Kg ne vitin 2011 nga 398,5 Lek/kg ne vitin 2010 .

Vlen te theksohet se gjate kesaj periudhe perpunimi u permiresua mjaft procesi teknologjik i perpunimit ne saje te nje rinovimi te paisjeve , te makinerive dhe kryerjes se nje remonti te mire te makinerive ne pergjithesi , gje e cila solli si rrjedhoje permiresimin e nivelit te firove te duhanit , qe per kete vit u realizua me 3,23% nga 10,5% te programuar.

Prodhimi i gatshem i realizuar gjat vitit 2011 per 1038 ton ishte i kontraktuar si zakonisht me kompanine Leaf Tobacco A.Michailides S.A. Selanik Greqi , i cili u eksportua brenda vitit kalendarik deri ne dt. 01/08/2011 rreth 98%, e pjesa e mbetur prej 2% ose 20 Ton kryesisht Skrap dhe Fines jane gjendje ne magazine , nga e cila u realizua nje e ardhur prej 3.340.296,35 Euro, me vlefte prej 471.507.868 lek.

Keto fenomene dhe dukuri shfaqen edhe ne rritjen e treguesve ekonomiko-financiare si cmimi i blerjes, treguesi i koston dhe cmimin e shitjes per eksport. Ne aspektin e rritjes se te ardhurave per njesi gjate vitit 2011 pati influence rritja e kursit valutor , siç tregohet ne pasqyren e meposhtme :

Pasqyra Permbledhese e Realizimit te Kosros, Cmimit te shitjes
per Eksport sipas viteve

Periudha	Kostot per njesi prodhimi	Cmimi mesatar i shitjes		Kursi mesatar valutor
		EURO	LEK/KG	
Viti 2007	282,00 lek/kg	2,460	307,00	123,60
Viti 2008	299,00 lek/kg	1,819	222,58	122,32
Viti 2009	352,00 lek/kg	2,980	389,79	130,78
Viti 2010	353,25 lek/kg	2,900	398,50	137,41
Viti 2011	362,00 lek/kg	3,280	463,00	141,16

Aktiviteti ekonomiko-financiar i ketij viti eshte perballuar nga thithja e nje fuqie punetore sezonale ne periudhe ngarkese te plote prej 206 punetoresh dhe ne periudha “piku” pune prej 265 punetore , aktivitet i cili realizohet ne 6-7 muaj pune duke realizuar nje fond page gjithsej prej 39.995 mije Lek nga te cilat 26.669 mije Lek per punetoret e prodhimit dhe 13.325 mije Lek per administraten prej 26 personash.

Ky aktivitet ekonomik-financiar eshte pasqyruar dhe ne raportin e ekspertit kontabel te autorizuar i cili ka paraqitur raportin e Auditimit te llogarive vjetore 2011 ku shprehet vleresimi i tij ne disa aspekte.

Konkretisht dy ekspertet kontabel te autorizuar , Znj. Etleva Ashiku nga Korça dhe Z. Artan Golemi nga Tirana konrolluan gjithë pasqyrat financiare te perpiluara sipas standartit te S.K.K.2 per te cilat do te paraqitin materialin e tyre te Auditimit.

Krijimi i mendimit ekonomik mbi rezultatin e ketij subjekti paraqitet ne pasqyren e meposhtme :

Treguesit Ekonomiko – Financiare per vitet 2007 – 2011

	<u>Viti 2007</u>	<u>Viti 2008</u>	<u>Viti 2009</u>	<u>Viti 2010</u>	<u>Viti 2011</u>
<u>Prodhimi Ton</u>	1.500	874	596	978	1038
<u>Ekporti Ton</u>	2.042,8	924	596	978	1018
	<u>Viti 2007</u>	<u>Viti 2008</u>	<u>Viti 2009</u>	<u>Viti 2010</u>	<u>Viti 2011</u>
<u>Te Ardh.nga shitja e duh.</u>					
EURO	5.035.748	1.681.721	1.777.861	2.833.043	3.340.296
LEK	627.501.656	205.714.510	232.500.764	389.279.612	471.507.868
<u>Te Ardh. gjithsej</u>					
LEK	633.834.553	246.673.061	249.107.090	408.343.749	545.164.927
<u>Shpenz. gjithsej</u>					
LEK	572.619.557	305.792.953	236.077.703	391.256.345	518.999.368
<u>Fitimi nga veprimt te zak.</u>					
LEK	+ 61.214.996	- 59.119.892	+13.029.387	+17.087.404	+ 26.165.559
<u>Shpenzime te pazbritshme</u>					
LEK	4.707.751	2.048.305	5.377.704	6.269.222	+ 12.399.416
<u>Humbje te trasheguara</u>					
LEK	=	=	- 3.531.859	=	=
<u>Fitimi para tatimi</u>					
LEK	=	=	14.875.232	23.356.626	38.564.975
<u>Tatim Fitimi 20% / 10%</u>					
LEK	6.577.358	=	1.487.523	2.335.663	3.856.497
<u>Fitimi Neto</u>					
LEK	54.637.638	- 59.119.892	11.541.864	14.751.741	22.309.062
<u>Fitimi Neto Mika Berat</u>					
LEK	=	55.588.033	=	=	=

Per nxjerrjen e rezultatit tatimor per vitin 2011 subjekti morri ne konsiderate dhe shpenzimet e pazbritshme per shumen 12.399.416 Lek, shpenzime pritje percjellje dhe hotelerie, shpenzime per transport personeli, kamat vonesa, karta celulari, karburantet e autoveturave, shpenzime te periudhave te ardhshme per Beratin , ndryshimi i vleresimit te prodhimit te gatshem, shpenzime te cilat sjellin rritjen e fitimit te tatueshem.

Meqenese subjekti per vitin 2011 rezultoi me fitim, tatim fitimi i llogaritur per t'u derdhur per kete periudhe ushtrimore eshte 3.856.497 lek duke marre ne konsiderate dhe shpenzimet e pazbritshme prej 12.399.416 lek.

Duhet te bejme me dije kete Keshill Mbikqyres se shpenzimet e pazbritshme (te panjohura) prej 12.399.416 lek per vitin 2011 perbehen nga :

- 1) Shpenz. Pritje Percjellje – Perfaqesimi per 3.981.604 lek nga te cilat 2.802.498 lek jane te trasheguara nga ish subjekti “Mika-Berat” ne lidhje me faturen e vitit 1994 te Leaf Tobacco A.Michailides S.A , shpenzime te cilat konsiderohen te pazbritshme ,

ndersa diferenca prej 1.179.106 lek jane shpenzime qe njihen nga Ligji Nr.8438 date 28.12.1998 Neni 12/3 germa f .

- 2) Shpenz.Transport Personeli per vleften 964.600 lek qe kane te bejne me taksite dhe fugonat e marre ne dispozicion nga tekniket dhe personeli i ketij subjekti sipas zonave .
- 3) Shpenz.Poste-Telekomunikacioni per vleften 82.250 lek si shpenzime telefonike fikse dhe karta celulari .
- 4) Gjoha e Kamate-Vonesa per vleften 2.012.143 lek
- 5) Blerje karburante per autoveturat e huaja per vleften 1.326.565 lek , automjete qe nuk jane ne pronesi te subjektit – kryesisht ato jane te kompanise Leaf Tobacco A.Michailides S.A .
- 6) Rivleresimi i gjendjes se prodhimit te gatshem ne daten 31/12/2011 per 2.430.935 lek .
Konkretisht vlefte e paraqitur me kosto (190 lek/kg) rezulton ne 3.817.604 lek, ndersa ajo e rivleresuar simbas cmimit te tregut (69,0137 lek/kg = 0,50 Eur) paraqitet per 1.386.669 lek , mbasi e gjithe sasia prej 20 Ton eshte e cilesise se ulet (Skrap dhe Fines) .
- 7) Shpenz.Mirembajtje automjetesh etj per 2.780.425 lek jane shpenzime te trashaguara nga subjekti Ish “Mika Berat” , te krijuara nga Leaf Tobacco A.Michailides S.A. qe nga viti 1994 (shpenzime per tu shperndare ne periudhat e ardhshme) .

Ne muajin Dhjetor 2011 u krye inventarizimi i gjithe vlerave materiale qarkulluese per zonen Korce dhe Berat , si materiale fabrike ne magazine , lende e pare , prodhim i gatshem , inventar i imet , amballazhe etj , ne te cilat nuk rezultuan diferenca ne mungese me perjashtim te magazines te prodhimit te gatshem ku rezultoi nje teprice prej 1.163 kg dhe vlefte 221.093 lek .

Gjate inventarizimit te Mjeteve Kryesore ne zonen Berat si Ndertesa , Makineri te Patrupezuara dhe Inventar Ekonomik rezultuan ne gjendje jashte perdorimit :

1 – Zeri Ndertesa - Koceke ne Sheqez per vleften 59.630 lek , vlefte e cila kompesohet nga amortizimi i akumuluar per shumen 31.504 lek dhe diferenca 28.126 lek kalon ne shpenzimet e vitit ushtrimor (Llog.662) .

2 – Zeri Makineri te Patrupezuara per vleften 5.763.563 lek , vlefte e cila kompesohet nga amortizimi i akumuluar per shumen 1.798.879 lek , vlefte 3.957.094 lek kalon ne shpenzimet e vitit ushtrimor (Llog.662) dhe diferenca prej 7.590 lek kalon si materiale mbeturine skrap (Llog.3127) .

3 – Zeri Inventari Ekonomik per vleften 1.175.361 lek , vlefte e cila kompesohet nga amortizimi i akumuluar per 1.097.390 lek , vlefte 75.721 lek kalon ne shpenzimet e vitit ushtrimor (Llog.662) dhe diferenca prej 2.250 lek kalon me materiale mbeturine skrap (llog.3127) .

Perfundimisht vlefte prej 4.060.941 lek kalon ne shpenzimet e prodhimit te vitit ushtrimor , humbje (llog.662) , per vleften kontable te mbetur te Akt.Afatgjata te Patrupezuara te cilat i propozohen Keshillit Mbikqyres per nxjerrje jashte perdorimit dhe per miratim .

Ne perfundim te gjithe aktivitetit ekonomik – financiar te vitit 2011 , Fitimi Neto i mbetur per vleften 22.309.062 lek i propozojme ketij Keshilli Mbikqyres te kaloje ne zvogelimin e Humbjeve te Trashaguara prej vitesh qe aktualisht paraqitet ne masen prej 282.400.707 lek.

Bejme te ditur se viti ushtrimor 2011 nga ana e sistemit kontabel u veprua per nxjerrjen e rezultateve perfundimtare me kerkesat e standartit kombetar te Kontabilitetit (SKK2), i cili ne specifiken e tij paraqet elementet e tij aktive dhe pasive ne pozicione te ndryshme te percaktuara ne pasqyrat financiare.

Per vitin 2011, rivleresimi i llogarive aktive dhe pasive ne monedhe te huaj per gjendjen ne daten 31/12/2011 me kursin valutor te Bankes te Shtetit te dates 31/12/2011 (1 Euro = 138,93 lek/Eur) dhe (1 USD = 107,54 lek/Usd) eshte perfshire ne rezultatin e ketij viti me nje efekt negativ prej 51.071.900 lek duke njohur efektin e konvertimit per llogarite aktive ne shumen 42.898.454 lek dhe pasivit ne shumen 93.970.354 lek .

Perberja e cdo elementi te Aktivit, Pasivit dhe Te Ardhurave dhe Shpenzimeve te paraqitura sipas pasqyrave financiare te perpiluara sipas S.K.K.2 shpjegohen ne materialin shoqerues te bilancit te dates 31/12/2011.

Siç permendem edhe me siper ne vitin 2011, grumbullimi i duhanit pati nje rritje kundrejt prodhimit te vitit 2010 ne rreth 4,5% , tregues i cili vjen duke u rritur nga viti ne vit , rritje e cila vjen si rezultat i rritjes te masave tekniko-organizative me synim qe te stimulohet rritja e prodhimit te duhanit dhe me objektiv qe per 3-4 vitet e ardhshme sasia e duhanit te dyfishohet duke arritur qe te merret nje prodhim prej 1,5 milion Kg.

Mbi keto masa tekniko-organizative te marra eshte ndertuar objektivi tone te cilin mund ta paraqitim si me poshte :

1- Me qellim qe prodhuesit te kene kohe per mbjelljet e reja, prodhimi i tyre u vendos qe cdo vit t'u merret atyre me shpejt se cdo vit tjeter ne muajt Tetor, Nentor, Dhjetor, Janar te cdo viti pasardhes.

2- Likuidimi i duhaneve te grumbulluara te behet ne nje kohe sa me te shpejte brenda 10 diteve maksimumi 15 dite pas blerjes.

3- Prodhuesve me nje organizim me te mire t'u jepet ne kohen e duhur falas baza materiale si fara, culla, kanavace, kuti kartoni dhe kundrejt pageses me nje perqindje te percaktuar nga Drejtoria iu jepen pjeserisht Pleh kimik , Pesticide , Sera Diellore, Plasmas per serat, Makineri Shkuarje Duhani etj.

4- Sivjet dhe vitet ne vazhdim fermereve po u vihet ne ndihme me nje staf me te kualifikuar agronomik. Ne zonat ku kultivimi i duhaneve eshte i madh si ne Elbasan, Korçe , Berat, eshte rritur numri i agrnomeve te pergatitur ne shkollat e larta, me gjuhe te huaja e qe kane njohuri te mira agronomike e kompjuterike, si e tille edhe klasifikimi, vleresimi dhe dorezimi i duhaneve do te behet ne disa qendra blerjeje, ne zona sa me afer kultivuesve. Do te kete nje staf te perhershem :

- ne zonen e Elbasanit pese specialiste te larte
- ne zonen e Beratit tre specialiste te larte
- ne zonen e Korces tre specialiste te larte

5- Mbeshtetur ne kerkesat e kontraktoreve te medhenj si Filip Moris (qe eshte nje garanci per prodhimin shqiptar, por edhe pergjegjesi per standartet e larta te duhanit te kerkuara) , do te kultivohet e prodhohet duhani i tipit "Katerini" varietet i perqafuar mjaft mire edhe nga fermeret e Korces ne baze te kontrates te lidhur me cdo fermer.

6- U percaktuan per vitin 2011 dhe ne vazhdim , e perseri do te caktohen cmime mjaft stimuluese per varietetin "Katerini". Jane percaktuar 22 shkalle cmimesh te cilat jane afishuar ne cdo pike, duke u percaktuar edhe ne kontratat duke filluar nga shkalla e pare 460 Lek/Kg, e dyta 440 Lek/Kg, e treta 400 Lek/Kg e me rradhe. Gjate vitit 2011-2012 cmimet jane rritur ne masen 7-10% dhe me keto masa te marra si me siper kane bere te mundur qe siperfaqja e mbjelle ne vitin 2011 te rritet duke garantuar nje prodhim mbi 1.1 milion kg, aq sa ishte parashikimi. Ato perbejne nje garanci per objektivat e subjektit ne vazhdim.

7- Here pas here jane nxjerre informacione dhe u jane shperndare fermereve simbas fazave te prodhimit duke filluar nga farishtja e me rradhe deri ne dorezimin e prodhimit me qellim qe te informohet dhe rrisin kujdesin per rritjen e cilesise se duhaneve.

8- Ne bashkepunim te ngushte edhe me Agjensine Kombetare te Duhani Cigareve dhe te Drejtorive te Bujqesise ne rrethe, jane organizuar dhe do te organizohen seminare

kualifikimi, me fermeret ne zona te ndryshme nga te cilat keto vit 4 ne zonen e Elbasanit, 3 ne zonen e Beratit dhe 2 ne te tjerat.

9- Ne vitin 2011 Investimet u realizuan ne masen 75.000 Euro duke bere te mundur qe te rikonstruktohen te gjitha depot e duhanit me mbulesa te re catie per te eliminuar lageshtine si dhe te kryhen suvatimet e jashtme dhe te brendshme te tyre plus lysterjet .U rikonstruktua komplet Ndertesat e Kaldajes dhe u zevendesua tere sistemi ushqyes dhe ndezes i kaldajes . U krye rinovimi ne disa linja te makinerive te perpunimit.

Investimet per vitin 2012 parashikohet te kalojne vleften e 120 000 Eurove, investime te cilat do te transformojne fabriken ekzistuese ne nje fabrike moderne dhe te kohes per depozitimin , manipulimin dhe perpunimin e duhaneve ne standartet e niveleve me te larta qe ofrojne keto tipe fabrikash dhe qe terheqin klientet me te fuqishem te prodhimit te cigareve ne Bote e ne vecanti te Filip – Morrisit Amerikan .

Masat e mesiperme e te tjera si keto qe do te merren ne vazhdimesi te periudhes kane si qellim :

Te ndjeke tek prodhuesit e duhanit gjate tere periudhes vjetore, zbatimin e teknologjive me te perparuara, per rritjen, zhvillimin, vjeljen, tharrjen, manipulimin dhe grumbullimin e duhanit.

Ne vitin 2012	1200 – 1400 Ton duhane
Ne vitin 2013	1400 – 1600 Ton duhane
Ne vitin 2014	mbi 1600 Ton duhane

Realizimi i ketij prodhimi do te beje qe ne vitin 2012 e sidomos ne vitet 2013-2014 jo vetem subjekti te kete te ardhura te kenaqshme por edhe do te rikuperoje pjeserisht humbjet e mbartura dhe si rrjedhoje permiresimin e gjendjes aktuale te kapitaleve te nenshkruara .

K/Deg.Ëkon-Fin-Menaxhim

Aleku Mitezi

